

PJESA E PARË

Impetuoso - Fiero

1

Në fakt, nuk e di me saktësi se si arriti Edit Lejvëri të lidhte miqësi me Izabel Istonin. Mbase kishin ndonjë mik të përbashkët ose shkonin në të njëjtin komitet, apo ndoshta thjesht i lidhte e njëjta floktore. Por me sa mbaj mend, shumë kohë më parë, për një arsye apo për një tjetër, Izabela vendosi të na e prezantonte Editin si gjetjen e saj: një zbulim disi i veçantë, të cilin ashtu siç bëjnë nikoqiret e mira, ajo duhet t'ua shërbente me kafshata të vogla miqve të saj në rrethina. Në fund, koha tregoi se ajo kishte pasur të drejtë. Megjithatë, kur e takova për herë të parë, nuk vura re asnjë gjurmë që të më ndizte shkëndija ngjarjesh tronditëse, si ato që ndodhën. Edhe atëherë Editi ishte tejet e bukur, por sigurisht jo aq sa do të bëhej më vonë, kur, siç thonë stilistët, e gjeti stilin e saj. Ajo ishte model: një bionde tipike angleze, me sy të mëdhenj dhe me një sjellje mjaft të këndshme.

E njihja Izabel Istonin që kur ishim fëmijë dhe jetonim në Hempshajër. Ajo që na lidhte ishte një miqësi e mirë dhe pa kërkesa të veçanta. Nuk kishim shumë të përbashkëta, por disa të njohur na kujtonin ende kohët kur ishim nëntë vjeç, të hipur mbi kuajt tanë të vegjël dhe kjo ndillte një lloj rehatie, sa herë që takoheshim rastësisht me njëri-tjetrin. Pas përfundimit të universitetit, unë i hyra rrugës së teatrit, ndërsa Izabela u martua me një agjent burse dhe u largua drejt Sjuseksit, kështu që udhët tona nuk para kryqëzoheshin më. Nëse për Izabelën ishte një lloj argëtimi i veçantë të rrinte me një aktor, të cilin për më tepër e kishin parë në televizor (edhe pse asnjëri nga miqtë e saj nuk më kishte parë ndonjëherë), për mua ishte vërtet kënaqësi që të kaloja një fundjavë jashtë të zakonshmes me miken e vjetër të lojërave të fëmijërisë.

Rastisa në Sjuseks herën e parë që Editi u bashkua me të tjerët dhe mund t'jua dëshmoj me detaje ngazëllimin e pashoq që po përjetonte Izabela rreth mikeshës së saj të re: ngazëllim që më pas filloi të zbehej, për shkak se, me sa duket, ajo nuk e njihnte edhe aq mirë. Megjithatë, në fillim ishte mjaft e sinqertë: “Do t’i buzëqeshë fati. Ajo ka diçka të veçantë”. Izabela e kishte shumë për zemër të përdorte fjali që dukej se fshihnin një

njohje të thellë të universit dhe të mënyrës se si funksiononte ai. Dhe rreth gjysmë ore më vonë, në çastin kur Editi zbriti nga makina, jam i sigurt që disa mund të kenë menduar se nuk dukej se kishte ndonjë veçanti të madhe, përveç pamjes së saj të jashtme dhe një joshjeje shplodhëse, por unë isha i prirur të isha i një mendjeje me mikpritësen. Kur e risjell në kujtesë atë çast, kuptoj se duhet ta kisha vënë re në gojën e saj një shenjë paralajmëruese të asaj që do të ndodhte: një gojë e kristaltë, nga ato të ravijëzuarat më së miri, me buzë gati të gdhendura, që ne zakonisht i lidhim me imazhet e aktoreve të viteve dyzet. Pastaj, edhe lëkura e saj... Në fakt, ekziston një rregull i pashkruar për britanikët, sipas të cilit të bësh një kompliment për lëkurën, je duke përdorur armën e fundit për të lajkatur dikë, që nuk ka asgjë për t'u lavdëruar. Lëkura e mirë zakonisht është një temë që bëhet tërkuzë, kur diskutohet për ndonjë prej anëtarëve më të rëndomtë të familjes mbretërore. Por të themi të drejtën, Edit Lejvëri kishte vërtet lëkurën më të bukur të fytyrës që kisha parë ndonjëherë: të freskët, të pastër, me ngjyrë gruri, e gjitha e mbrojtur nga një shtresë e përsosur, si prej dylli. Gjithë jetën kam pasur një dobësi të veçantë për njerëzit e bukur dhe sa herë hedh sytë pas, mendoj se u bëra aleat i Editit, që nga çasti i parë që u përballa me fytyrën e saj. Sidoqoftë, Izabela dukej se po priste të shndërrohej në një profete të vetëshpallur, për sa kohë ishte ajo që e çoi Editin drejt Brautonëve.

Shtëpia periferike Brauton ose siç mund të quhet me të drejtë shtëpia e vërtetë e Brautonëve, ishte një plagë e mahisur që cungonte çdo aspekt të jetës së Istonëve në Sjuseks. Në fillim baronë, më pas kontë dhe së fundi, që prej vitit 1879, markezë të Akfildit, Brautonët kishin ushtruar ndikim të fortë mbi këtë zonë të veçantë të Sjuseksit Lindor, krahasuar me pjesën më të madhe të sunduesve në qarqet rreth Londrës. Deri pak më parë se shekulli i kaluar, fqinjët dhe vasalët e tyre kryesisht ishin fermerë të rangut të ulët, që e nxirrnin bukën e gojës falë rrafshinës së ulët moçalore, e cila shtrihej në këmbët e kodrinave, por rrugët, hekurudhat dhe sajekat e aktiviteteve nga e shtuna në të hënë, kishin bërë që *haute bourgeoisie*¹ të vërshonte drejt kësaj zone, në kërkim të *ton*² dhe ashtu si Bajroni, Brautonët u zgjuan një mëngjes dhe zbuluan se ishin bërë të famshëm. Shumë shpejt të qenët i preferuar ose jo në atë zonë, përcaktohej kryesisht nga fakti nëse ishe i përfshirë apo jo në listën e tyre të vizitave. Në fakt nuk i vë dot fre gjuhës, ndaj nuk

1. Borgjezia e rangut të lartë. (Të gjitha shënimet janë të përkthyeses.)

2. Moda e fundit.

mund të mos ju them se familja as që e deshi këtë popullaritet, të paktën jo në fillim, por si përfaqësuesit më të rëndësishëm të *anciens riches*³ në një zonë ku lëvizja po shtoej çdo ditë e më shumë, e gjetën veten përherë e më të fuqishëm pikërisht nga kjo situatë.

Megjithatë ata kishin qenë fatlumë edhe në drejtime të tjera. Dy martesë, njëra me vajzën e një bankieri dhe tjetra me trashëgimtarën e një “ngastre të majme” në San Francisko, kishin bërë të mundur që anija e familjes t’i bënte ballë detit të tërbuar të depresionit bujqësor dhe të Luftës së Parë Botërore. Në ndryshim me shumë dinasti të ngjashme ata kishin arritur të kishin ende, në mos të gjitha, të paktën disa prej zotërimeve të tyre londineze dhe, falë disa hileve me pronat e paluajtshme gjatë viteve gjashtëdhjetë, kishin arritur të zbarkonin thuajse të sigurt në brigjet e Britanisë së zonjës Theçër. Pas kësaj, kur socialistët filluan të mblidheshin sërish në grupe, ata dolën në krye si të rilindurit e laburistëve të rinj, një hap i leverdishëm për mbarë klasën e lartë, që u përdor më shumë si një voli, sesa si një ndjekje parimore e gjurmëve të makutërisë politike të stërgjyshërve të tyre. Si përfundim, Brautonët u cilësuan si pika kulmore e “mbijetesës” së një familjeje angleze. Ata i kapën vitet nëntëdhjetë pa prekur jo vetëm prestigjin e tyre, por gati edhe të gjitha pronat e patundshme.

Jo se ndonjë prej detajeve të sipërpërmendura, u kishte krijuar probleme Istonëve. S’shqetësoheshin aspak nga privilegjet që gëzonte kjo familje, madje i adhuronin. Por vështirësia qëndronte në faktin se, edhe pse jetonin vetëm dy milje larg shtëpisë periferike Brauton, edhe pse Izabela u rrëfente mikeshave teksa drekonin në rrugën “Uolltën” se sa fat i madh ishte ta kishe këtë shtëpi “gati ngjitur”, pas tre vjet e gjysmë ata as që kishin vënë këmbë në të, madje ende nuk kishin mundur të takonin ndonjë prej anëtarëve të kësaj familje.

Sigurisht Dejvid Iston nuk ishte anglezi i parë i shtresës së mesme, që zbulonte se ishte shumë më e thjeshtë të trilloje për një prejardhje aristokratike në Londër, sesa në rrethina. Problemi ishte se pas vitesh të tëra që drekonte te “*Brook’s*”, që ndiqte të dielave garat e vrapimeve me kuaj dhe i kalonte pasditet tek “*Anabel’s*”, duke hedhur lart e poshtë paragjykime pa fund kundër shoqërisë moderne gjithmonë në lëvizje, e kishte humbur fare sensin se edhe ai vetë, nuk ishte veçse një fryt i kësaj shoqërie. Dukej sikur e kishte harruar se i ati ishte administratori i përgjithshëm i një kompanie të vogël mobilie në

3. Pasanikët e vjetër.

Midland dhe se prindërit kishin bërë të pamundurën për ta çuar në një kolegji si “*Ardingly*”. Kur e takova për herë të parë, m’u duk shumë i habitur se si emri i tij nuk ndodhej në guidën gjenealogjike të aristokracisë britanike “*Debrett’s*”. Njëherë, më kujtohet teksa diskutoja se kisha lexuar një artikull, ku citohej një keqardhje e Rodi Leuëllinit që nuk kishte mundur të ndiqte kolegjin “*Eton*” (ashtu siç kishte bërë vëllai i tij i madh), pasi vetëm në “*Eton*” mund të gjeje një miqësi që zgjaste tërë jetën. Atë çast, rastisi që Dejvidi po kalonte pranë karriges sime.

- Më se e drejtë, - tha. - Pikërisht kështu ndihem edhe unë.

Hodha një sy përçark dhomës, duke u përpjekur të ndeshja sytë e Izabelës, por nga tundja e këndshme e kokës së saj kuptova se ajo nuk donte të bëhej pjesë e komplotit tim, por të atij të bashkëshortit.

Dikujt që jeton jashtë këtij rrethi, fakti që secili prej bashkëshortëve mbështet iluzionet e tjetrit do t’i dukej element jetik i martesës. Deri më tani ai kishte qenë i mbrojtur nga ndërthurja e ëmbëlsisë së Izabelës me indiferencën e pjesës më të madhe të mikpritëseve londineze, ndaj gjithçkaje që s’kishte të bënte me aftësinë e miqve për të folur dhe për të ngrënë ushqimin, ndaj tani për të ishte shumë e bezdisshme të ulej në tryezë me njerëz të zgjuar, të cilët e pyesnin rreth udhëtimit të Çarlsit në Itali, apo se si po përshtatej bashkëshorti i ri i Karolinës, raste në të cilat i duhej të murmuriste se nuk i njihite këta të fundit.

“Sa e çuditshme! - ishte përgjigjja vijuese. - Mendoja se ishit fqinjë...” Por edhe në këtë rrëfim të Dejvidit kishte një lloj pandershmërie, sepse nuk ishte se ai në *fakt* nuk i njihite ata. Ai as që i njihite fare ata.

Dikur, gjatë një kokteji në sheshin “Iston” ai kishte guxuar të jepte një mendim mbi këtë familje, por fatkeqësisht bashkëbiseduesi i tij i kishte thënë:

“A s’është Çarlisi ai atje? Do të ishte interesante të më prezantoje me të dhe të shohim nëse e mban mend se ku më ka takuar më parë...”

Dhe Dejvidit papritmas i ishte dashur të thoshte se nuk ndihej mirë (gjë që deri diku ishte e vërtetë) dhe se duhet të nisej për në shtëpi, duke humbur drekën, ku, më në fund, do të ishin gjendur të gjithë bashkë. Kohët e fundit kishte filluar të merrte një pamje disi mospërfillëse, sa herë që përmendej emri i tyre. Ai qëndronte i heshtur, nuk përziej fare në bisedë, sikur ai, Dejvid Iston, *as që* donte t’i njihite Brautonët. A thua se ai e kishte

pasur këtë mundësi dhe kishte zbuluar se ata nuk i përshtateshin aspak shijeve të tij. Pikërisht kjo ishte gjëja më e pavërtetë që mund të thuhej ndonjëherë. Të themi të drejtën, këto ambicie të porealizuara shoqërore në ndërgjegjen e Dejvidit ishin edhe më të ndrydhura, se sa ajo që shpërfaqte në sytë tanë. Ose të paktën kështu m'u duk mua, teksa e pashë të mbërthente zinxhirin e *Barbërit*⁴ të tij dhe t'u fishkëllente qenve.

Me sa kuptova vizita u propozua nga Editi. Izabela na ftoi për mëngjes të shtunën dhe kur na pyeti se çfarë kishim qejf të bënim, Editi kujtoi se kishte një vend "madhështor" aty pari dhe pyeti nëse do të ishte e mundur ta vizitonim. Ajo pa nga unë.

- Për mua nuk ka problem, - i thashë.

Vështrova Izabelën që i hodhi sytë nga Dejvidi, i cili ishte ulur në anën tjetër të tryezës dhe ishte përqendruar në të përditshmen "*The Daily Telegraph*". Unë e dija se ç'ndodhte, ndaj e kuptova sikletin me çështjen Brauton. Edhe Izabela e dinte që unë e dija, edhe pse si çdo britanik, natyrisht as që kishim diskutuar ndonjëherë rreth kësaj çështje. Në fakt, unë e kisha takuar disa herë në Londër Çarls Brautonin, birin dhe trashëgimtarin më letargjik të familjes, në disa prej atyre mbrëmjeve të përziera në të cilat industria e spektaklit dhe shoqëria e lartë ndërthuren së bashku, por, ashtu siç ndodh edhe në pikën ku kryqëzohen dy lumenj, ujërat e tyre shumë rrallë trazohen me njëri-tjetrin. Të themi të drejtën, unë nuk i kisha treguar Izabelës për këto takime të rastësishme, pasi druhesha mos e vija gishtin në plagë.

- Dejvid? - tha ajo.

Ai ktheu faqen e gazetës me një gjest të qartë mospërfilljeje.

- Shkoni, nëse keni dëshirë. Më duhet të hidhem deri në Ljuis. Sotëni ka humbur sërish kapakun e karburantit të kositëses së barit. Ai sikur i ha kapakët.

- Po deshe shkoj unë të hënën.

- Jo, jo. Dua të marr edhe disa fishekë. - Ai ngriti sytë. - Vërtet, shkoni, nuk ka problem.

Në sytë e tij lexohej një lloj qortimi, të cilit Izabela iu përgjigj duke marrë një pamje shpërfillëse, si për t'i thënë se askush nuk po e detyronte të bënte diçka që s'i pëlqente. E vërteta ishte se mes tyre ekzistonte një marrëveshje e heshtur, sipas së cilës ata kurrë nuk do ta vizitonin atë shtëpi si "vizitorë të thjeshtë". Në fillim Dejvidi e kishte shmangur një

4. Një lloj xhakete tipike angleze, ngjyrë jeshile, e veshur me dyllë në sipërfaqen e jashtme, që përdoret kryesisht për gjueti. E ka marrë emrin nga tregtari britanik i pëlhurave, Xhon Barbër.

vizitë të tillë, pasi mendonte se shumë shpejt do të arrinte të njihej me familjen. Ai nuk donte të rrezikonte që të ndeshet për herë të parë me ta, teksa qëndronte në krahun e gabuar të kordonit. Dhe, meqë ato që pasuan doli se nuk ishin veçse muaj dhe vite të tëra zhgënjimi, të mos e vizitonte shtëpinë tani për të ishte shndërruar në një parim. Ai nuk donte t'u jepte Brautonëve kënaqësinë e të paguarit një dorë të mirë parash, për të vizituar atë që i takonte me të drejtë ta shihte falas. Por Izabela, ashtu si të gjitha gratë, ishte më praktike se bashkëshorti i saj dhe ishte mësuar me idenë se shumë shpejt do të zinin vendin që meritonin në këtë "rrethinë". Ndërsa tani ishte thjesht kureshtarë të shihte godinën, e cila ishte shndërruar në pikën e dobët të muskulit të tyre shoqëror. Prandaj edhe nuk u përpoq shumë që t'i mbushte mendjen. Kështu, ne të tre u rrasëm në Renonë e saj të keqpërdorur dhe u nisëm.

E pyeta Editin nëse e njihte ndopak Sjuseksin.

- Në fakt, jo. Dikur, për pak kohë kam pasur një mik në Çiçestër.

- Në skajin e modës.

- Pse i tillë është? Nuk e dija që edhe kontetë kanë skaje të modës. Duket si një sajese amerikane. Njësoj si prania e tryezave të mira dhe të këqija në një restorant.

- E njihni Amerikën?

- Kam qenë disa muaj në Los Anxhelos, pasi përfundova shkollën.

- Pse?

Editi qeshi.

- Pse jo? Pse shkon kudo qoftë një shtatëmbëdhjetëvjeçar?

- Nuk e kuptoj pse dikush shkon në Los Anxhelos. Në mos po për t'u bërë një yll kinemaje.

- Ndoshta doja të bëhesha një yll kinemaje.

Ajo më buzëqeshi në një mënyrë, që unë e kuptova si një formë të zakonshme të shprehjes së hidhërimit. Aty vura re se sytë nuk i kishte të kaltër siç më ishin dukur në fillim, por në një gri të përzier.

Ne morëm kthesën pranë një moli madhështor prej guri, ku në majë të thellësimatësve spikatnin kokë e brirë drerësh prej plumbi dhe vazhduam nëpër një rrugë të gjerë të shtruar me zhavorr. Izabela e ndali makinën.

- A s'është e mrekullueshme! - tha ajo.

Silueta e stërmadhe e shtëpisë periferike Brauton u shpalos sa gjatë e gjerë para nesh. Editi buzëqeshi plot entuziazëm dhe ne vazhduam rrugën drejt ndërtesës. Ajo, ashtu si edhe unë, nuk mendonte se kjo shtëpi ishte e mrekullueshme, edhe pse në fakt ngrehina të linte pa fjalë. Sidoqoftë, ajo ishte madhështore. Me sa dukej ishte projektuar në shekullin e tetëmbëdhjetë, nga një paraardhës i Albert Shperit. Godina kryesore, një kub gjigant graniti, lidhej me dy kuba më të vegjël anësorë nëpërmjet dy kolonadash të rënda dhe të ngjeshura. Fatkeqësisht, një prej Brautonëve të shekullit të nëntëmbëdhjetë i kishte hequr dritaret mes këtyre trarëve të mëdhenj dhe i kishte zëvendësuar me xham të thjeshtë, ndaj ato dukeshin si të shqyera, të zbrazëta e të lëna pas dore, përgjatë gjithë kopshtit. Kubetë e ndërtuara keq në të katër cepat e shtëpisë të krijonin idenë e kullave të vëzhgimit në një kamp përqendrimi. Me një fjalë, më shumë se ta kompletinin pamjen, ato e shëmtonin atë.

Makina kërciti butë ndërsa ndalte pranë një vendqëndrimi.

- Mendoni të vizitohet në fillim shtëpinë apo kopshtin?

Izabela, si të ishte një inspektor ushtarak sovjetik i vitit 1960 që kishte arritur të fuste këmbët në NATO, ishte e vendosur të mos i shpëtonte asgjë.

Editi mblodhi supet.

- Ka shumë për të parë brenda?

- Oh, besoj se po, - tha vendosmërisht Izabela teksa ecte me hapa të mëdhenj drejt portës ku shënohej: "Hyrja". Ajo u struk në kurthin e shkallëve të mëdha e të rënda në formë patkoi, të cilat do ta çonin drejt *piano nobile*⁵. Graniti fshataresk e përpiu dhe ne e ndoqëm të bindur nga pas.

Një nga historitë më të parapëlqyera të Editit do të ishte gjithmonë ajo se, për të parën herë, e kishte parë shtëpinë periferike Brauton si një vizitore me pagesë, ku intimiteti i shtëpisë kufizohej nga një kordon i kuq.

"Jo se, - do të theksonte ajo më pas me atë gjysmë qeshjen e saj gazmore, - ky vend kishte pasur ndonjëherë një jetë edhe aq intime."

Ka shtëpi me një domethënie kaq të madhe për atë që e ka ndërtuar, me një damkë gjithëpushtuese të të gjitha jetëve që janë jetuar në të, saqë vizitori e ndien veten si një ndërthurje mes një hajduti dhe një fantazme, duke përgjuar një vend të fshehtë, të

mbushur plot me sekrete të mistershme. Por shtëpia periferike Brauton nuk ishte aspak një vend i tillë. Ajo ishte projektuar që nga rrjeta metalike që shtrihej në themele e deri te zbukurimi më i fundit, me një qëllim të vetëm: t'i linte pa mend të huajt. Dhe pas gjithë këtyre viteve, në fund të shekullit të njëzetë, roli i saj kishte vazhduar të mbetej po i njëjti. Ndryshimi i vetëm ishte se tani të huajt blinin bileta, në vend që t'i jepnin bakshishe nën dorë administratores së shtëpisë.

Gjithsesi, për vizitorët modernë, shkëlqimi i dhomave kryesore sikur ishte zbehur dhe dhoma e ftohtë dhe e lagësht ku hymë fillimisht (më vonë do të merrnim vesh se ajo konsiderohej si “Dhoma e nëndheshme”) ishte po aq mikpritëse, sa edhe një stadium i braktisur. Një mori karrigesh të rënda qëndronin mbështetur pas mureve, duke shkaktuar një ndjesi orësh të pafundme mërzie të çuara dëm duke qëndruar ulur mbi to, ndërsa qendra e dhomës mbushej nga një tryezë e gjatë, e zezë, që qëndronte mbi dyshtemenë e çngjyrosur prej guri. Përveç katër peizazheve të pista të Venecias, që mund të ishin gjithçka përveçse një Kanaletto, mbi mure nuk gjendej asnjë pikturë tjetër. Ashtu si të gjitha dhomat në shtëpinë periferike Brauton, salloni i pritjes ishte tejet gjigant, duke na bërë të treve të ndiheshim si *huamarrësit*⁶.

- Me sa duket nuk besojnë fare tek të qenët i përkorë, - tha Editi.

Duke shtrënguar fort në duar librat udhërrëfyes përparuar nga Dhoma e Nëndheshme drejt shkallëve madhështore, shkallaret e gdhendura prej lisi të të cilave kacavareshin përgjatë një skulpture masive bronzi, ku pasqyrohej një skenë mjaft e trishtë e një skllavi që po jepte shpirt. Pasi kaluam sheshpushimin e gjerë, u përballëm me “Sallonin e mermertë”, një hapësirë e gjerë e ndarë në dy pjesë, me një hajat të qarkuar nga të katër anët me parmakë, i cili ndodhej në nivelin e katit të dytë. Nëse do të kishim hyrë nga shkalla e jashtme në formë patkoi, ky do të kishte qenë prezantimi ynë i parë me shtëpinë (qëllimisht marramendës). Prej këtu ne vazhduam drejt Sallonit, një tjetër dhomë e pamasë, e zbukuruar me ornamente të rënda druri të kuq, të cilat dilnin edhe më në pah falë kornizave ngjyrë ari të mureve veshur me letra të kadifenjta në ngjyrë të kuqërremtë.

5. Në arkitekturë njihet si *kati fisnik* - ishte kati përdhes dhe më i rëndësishëm në pallatet e Rilindjes.

6. Është një roman i Meri Norton, në të cilin flitet për disa liliputë që “marrin hua” sende nga njerëzit e zakonshëm, pa u shfaqur asnjëherë para tyre.

- Unë dua **tikka pule**⁷, - tha Editi.

Qesha. Ajo kishte të drejtë. Ngjante njëloj si një restorant gjigant indian.

Izabela hapi librin udhërrëfyes dhe filloi të lexonte me zërin e një mësueseje gjeografie:

“Letra që vesh muret e sallorit është e njëjta që përdorej edhe në kohët e hershme, dhe mbahet si një prej joshjeve kryesore të dekorimit të brendshëm të vilës periferike Brauton. Tryezat e praruara në kënde janë bërë enkas për këtë dhomë nga Uilliam Kenti, në vitin 1739. Tema bregdetare e gdhendjes së pasqyrave që veshin hapësirat mes dritareve buron nga frymëzimi i kontit të tretë të kësaj shtëpie, i cili për shkak të detyrës ka banuar në ambasadën britanike në Portugali, në vitin 1737. Ky vend është si një përshpirtje e kontit, ndaj në këtë dhomë, që ai e pëlqente mbi të tjerat, varen në të dyja anët e oxhakut italian portreti i tij sa faqja e murit, i realizuar nga Xharvisi, dhe ai i konteshës, realizuar nga Hadsoni”.

Editi dhe unë ua ngulëm sytë pikturave. Ai i lejdit Brauton të bënte menjëherë për vete, me atë entuziazmin e një zonjushe të re trupmadhe ulur mbi një piring lulesh, teksa një kapelë verore sapo i kishte rënë nga dora e gjerë.

- Në palestrën ku shkoj unë është një grua që ngjan kopje me të, - tha Editi. - Ajo përherë përpiqet të më shesë bileta të lotarive konservatore.

Izabela vazhdoi të murmuriste:

“Dollapi që gjendet në mes të murit jugor është realizuar nga Buje, dhe është një dhuratë nga Mari-Jozefinë e Saksonisë, vajza më e madhe e mbretit të Francës, kushtuar nuses së kontit të pestë me rastin e martesës së saj. Mes dritareve... “

Lëvizja ngadalë drejt këtyre dritareve të vogla, të gjitha të ngjashme me njëra-tjetrën dhe hodha sytë nga parku. Ishte një nga ato ditët e zymta e të nxehta të gushtit të vonë, kur pemët duken të mbingarkuara me gjethë dhe gjelbërimi i lëndinave të fshatit është i paajër dhe si i bajatosur. Ndërsa po shikoja jashtë, dikush u shfaq prapa cepit të shtëpisë. Kishte veshur një xhaketë të lehtë dhe pantallona kadifeje me vija, edhe pse moti ishte i nxehtë dhe mbante një nga ato kapelat e mërzitshme të republikës prej shajaku ngjyrë kafe, me të cilat anglezëve kur rrinë në rrethina u duket vetja mjaft elegantë. Kur ngriti sytë vura re se ishte Çarls Brauton. Më pa me bisht të syrit dhe vështroi tutje, por pastaj

7. Një pjatë tradicionale indiane me copa të vogla mishi ose zarzavatesh, të marinuara në një përzierje shumë pikante.

ndaloj dhe ngriti kokën sërish. Mendova se më njohu dhe tunda dorën në shenjë përshëndetjeje, veprim të cilit ai iu përgjigj me një lëvizje gati të papërfillshme dhe vazhdoi në punën e tij.

- Kush ishte ai? - pyeti Editi, e cila po qëndronte pas meje. Edhe ajo e kishte braktisur Izabelën e zhytur në psaltjen e saj.

- Çarls Brauton.

- Ndonjëri prej djemve të shtëpisë?

- I vetmi djalë i kësaj shtëpie, besoj.

- Do të na kërkojë të qëndrojmë për çaj me të?

- Nuk besoj. E kam takuar vetëm dy herë.

Çarlsi nuk na kërkoi të qëndronim për çaj me të dhe jam i sigurt se as që do t'i shkonte ndër mend të vinte të më fliste, sikur të mos e kishim rastisur rrugës teksa ktheheshim për te makina. Ai po bisedonte me njërin prej kopshtarëve të shumtë, të cilit i kishte rënë rruga atypari dhe mbaroi kur ne po kalonim përmes hajatit të mbyllur të shtëpisë.

- Përshëndetje, - tha ai duke tundur kokën me dashamirësi. - Çfarë po bëni këtu?

Dukej qartë që e kishte harruar emrin tim dhe ndoshta edhe se ku ishim takuar, megjithatë u tregua mjaft i këndshëm dhe qëndroi, duke pritur që unë t'i prezantoja edhe të tjerët.

Izabela, e zënë në befasi nga kjo shtytje e fortë dhe e papritur drejt "vendit ku ëndrrat bëhen realitet", kërkoi kuturu nëpër kokë të gjente diçka që do të shkaktonte një nxitje të fortë joshjeje në trurin e Çarlsit, gjë që do të sillte më pas një miqësi të ngushtë, që pak a shumë do të lindte menjëherë. Por nuk pati as edhe një frymëzim.

- Ai po rri te ne. Ne banojmë vetëm dy milje larg, - tha ajo troç.

- Vërtet? A vini shpesh këtej?

- Ne këtu jetojmë.

- Ah, - tha Çarlsi. Pastaj u kthye nga Editi: - Edhe ju në këtë zonë banoni?

Ajo buzëqeshi.

- Mos u shqetësoni, jam e parrezikshme. Unë jetoj në Londër.

Ai qeshi dhe tiparet e tij të përzemërta për një çast u dukën mjaft tërheqëse. Hoqi kapelën dhe nxori në pah flokët e tij biondë, si të Rupert Brukut, me kaçurrela të vogla që në zverk shndërroheshin në rrica, karakteristike kjo për aristokratët anglezë.

- Shpresoj t'ju ketë pëlqyer shtëpia.

Editit buzëqeshi, kurse unë nuk thashë asgjë duke e lënë Izabelën të dërdëlliste pa fre rreth fakteve të kota të librit udhërrëfyes.

Më në fund ndërhyra duke kërkuar ndjesë.

- Duhet të shkojmë. Ndryshe Dejvidi do fillojë të bëhet merak.

Kështu, ne i buzëqeshëm njëri-tjetrit, u përshëndetëm me kokë, shtrënguam edhe duart dhe, pas pak minutash, u gjendëm sërish në rrugën e kthimit.

- Ti nuk më ke thënë kurrë se e njihje Çarls Brautonin, - tha Izabela me ton të prerë.

- Po, në fakt nuk e njoh.

- E po, nuk më kishe thënë as që e ke takuar.

- Nuk ta paskam thënë?!

Edhe pse, në të vërtetë, e dija që nuk ia kisha thënë. Izabela e bëri rrugën e kthimit në heshtje. Editi ktheu kokën nga sedilja e pasagjerit dhe pa folur bëri shenjë se dukej që i kishte mbetur hatri. Ishte më se e qartë se e kisha zhgënjyer, ndaj Izabela më qëndroi ftohtë gjithë fundjavën.